



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2019:298640

Datë: 15.03.2024

Numri i dokumentit: 05458817

E.nr.678/23

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtarin Faton Ajvazi, me bashkëpunëtorin profesional Besart Selmani duke vendosur në lëndën e përbarimit të kreditorit B.R., të cilin i përfaqëson Av. Qëndrim Reçica nga Lipjani, kundër debitorit Komuna Shtime-Drejtoria e Arsimit, për pagesën e shumës në emër të shtesës ushqimore, për udhëtim, shpërblim jubilar dhe shpenzimet e procedurës, më datë: 15/03/2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDON procedura përbarimore në lëndën E.nr.678/23, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorit.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.678/23, të datës 15/05/2023, e ka caktuar përbarimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorëve kundër debitorit Komuna Shtime-Drejtoria e Arsimit, për pagesën e borxhit dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të Aktgjykimit: 2019:298640, të datës 10.05.2021.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përbarimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 19/09/2023, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 1,281.30 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorit.

Meqenëse kreditorja e ka realizuar kërkesën e saj, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përbarimore në këtë çështje juridike përbarimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

E.nr.678/23, më datë 15.03.2024

GJYQTARI

Faton Ajvazi